

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Numri i lëndës: **Plm.Kzz. 138/2016**  
**(P. nr. 132/14 Gjykata Themelore e Mitrovicës)**  
**(PAKR 474/15 Gjykata e Apelit)**

Data: **14 korrik 2016**

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e Gjykatës Supreme Valdete Daka (si kryetare i kolegjit), gjyqtarja e EULEX-it e Gjykatës Supreme të Kosovës Elka Filcheva-Ermenkova (gjyqtare referuese), dhe gjyqtari i Gjykatës Supreme të Kosovës Nebojsa Boricic, si anëtarë të kolegjit, dhe zyrtarja ligjore e EULEX-it Sandra Gudaityte, në cilësi të procesmbajtëses, në çështjen penale kundër të pandehurit:

G. G.

i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorit të EULEX-it në Gjykatën Themelore të Mitrovicës Nr. PP. 10/14 të ngritur më 14 nëntor 2014, me qartësimin e paraqitur më 8 dhjetor 2014, për veprën penale në vijim: **VRASJE E RËNDË** në kundërshtim të nenit 179(1)(5) dhe (1)(8) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje "KPK"), në lidhje me nenin 31 të KPK-së;

duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës M. H. i në emër të të pandehurit ' G. G. në 10 maj 2016;

pas shqyrtimit të përgjigjeve të paraqitura nga prokuroria e EULEX-it në Mitrovicë më 30 maj 2016, dhe nga Zyra e prokurorit të Shtetit (tani e tutje "Prokuroria") e paraqitur më 16 qershor 2016;

pas këshillimit dhe votimit më 14 korrik 2016;

në përputhje me nenet 432, 433 dhe 435 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje "KPP");

*lëshon këtë*

---

## AKTGJYKIM

---

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. 132/14, e datës 30 korrik 2015, dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 474/15, e datës 14 janar 2016, të paraqitura nga avokati mbrojtës *M. H.* në emër të të pandehurit *G. G.* më 10 maj 2016, refuzohet sie pabazuar.

### ARSYETIMI

#### **I. Historia e procedurës**

1. Më 14 nëntor 2014, Prokurori i EULEX-it në Gjykatën Themelore të Mitrovicës ngiti aktakuzën PP 10/14 kundër *G. G.*. Aktakuza u qartësua më 8 dhjetor 2014. I pandehuri u akuzua për vepër penale të Vrasjes së rëndë në kundërshtim të nenit 179(1)(5) dhe (1)(8) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së.
2. Më 8 dhe 23 dhjetor 2014, është mbajtur shqyrtimi fillestar në prani të të pandehurit, avokatit mbrojtës dhe prokurorit. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur më 30 qershor, 2, 9, 24, dhe 28 korrik 2015.
3. Më 30 korrik 2016, Gjykata Themelore e Mitrovicës me aktgjykimin e saj P. 132/14, shpall të pandehurin *G. G.* fajtor për veprën penale Vrasje e rëndë në kundërshtim të nenit 179(1)(5) dhe (1)(8) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së. I pandehuri dënohet me 15 vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim që nga data 19 shtator 2014 ishte llogaritur në dënimin e shqiptuar.

4. Më 27 gusht 2015, avokati mbrojtës i **G.G.** paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës.
5. Më 14 janar 2016, Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR 474/15, pjesërisht pranoi ankesën e avokatit mbrojtës të **G.G.** i cili sa i përket dënimit të shqiptuar. Aktgjykimi P. 132/14 i Gjykatës Themelore të Mitrovicës ishte ndryshuar siç vijon: i pandehuri **G.G.** i është dënuar me 10 vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim nga data 19 shtator 2014 është llogaritur në dënimin e shqiptuar. Për pjesën tjetër ankesa është refuzuar si e pabazuar.
6. Më 10 maj 2016, avokati mbrojtës i **M.H.** në emër të të pandehurit **G.G.** i, paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit P. 132/14 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. 132/14 të datës 30 korrik 2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 474/15 të datës 14 janar 2016.
7. Më 30 maj 2016, Prokuroria e EULEX-it në Gjykatën Themelore të Mitrovicës paraqiti përgjigje me të cilën i propozon Gjykatës Supreme ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. 132/14 të datës 30 korrik 2015 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR 474/15 të datës 14 janar 2016.
8. Më 16 qershor 2016, Prokuroria paraqiti përgjigje me të cilën i propozon Gjykatës Supreme ta refuzojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës **M.H.** në emër të të pandehurit **G.G.** i si të pabazuar, në përputhje me nenin 437 të KPP-së.

## II. Parashtrësit e palëve

### Parashtrësit e avokatit mbrojtës të **G.G.**

9. Avokati mbrojtës pretendon se Aktgjykimi P. 132/14 i Gjykatës Themelore të Mitrovicës i datës 30 korrik 2015 aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR 474/15 i datës 14 janar 2016 përmbajnë shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale siç përcaktohet me nenin 432(1)(1) dhe (2) 437 të KPP-së. Për këtë arsye mbrojtja i propozon Gjykatës Supreme ta shfajësojë të pandehurin sepse nuk është dëshmuar se ka kryer veprën

penale, ta bëjë ri cilësimin e veprës penale në Pjesëmarrje në rrahje nga neni 190(1) i KPK-së, dhe ta kthejë lëndën në rigjykim, ose ta ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale nga Vrasja e rëndë nga neni 179(1)(5) i KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së në veprën penale Vrasje nga neni 178 i KPK-së lidhje me nenin 31 të KPK-së, dhe ta shqiptojë një dënim më të butë.

10. Avokati mbrojtës pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me përmbajtjen e shkresave të lëndës. Avokati mbrojtës pretendon se provat e prezantuara gjatë gjykitimit (veçmas video incizimi nga CCTV në dyqanin 'XX' ishin në kundërtë me gjetjet e Gjykatës Themelore. Mbrojtja analizon video-incizimin në hollësi dhe pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë arritur përfundime të gabuara dhe kundërtëne. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është kundërtëne në vetvete, sepse në njërin anë aktgjykimi pohon se G.G. i ishte i vetëdijshëm se bllokimi i rrugës dhe pamundësia e vetëmbrojtjes ka mundur të rezultojë me vrasjen e X.H.K., dhe në anën tjetër është bëhet e ditur se viktima X.H.K. ishte i armatosur dhe i aftë t'i rezistonte sulmit-rrahjes.
11. Sipas avokatit mbrojtës, Gjykata e Apelit ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 394(1) të KPP-së pasi as nuk ka dhënë sqarime pse ishte refuzuar ankesa, e as nuk ka dhënë sqarimet që ishin në kundërtënie me provat e çështjes. Gjykata e Apelit lë anash arsyetimin sa i përket fakteve vendimtare dhe pjesa e ankesës në lidhje me elementin e dashjës për të kryer veprën penale në bashkëkryerje nuk ishte e vlerësuar.
12. Avokati mbrojtës pretendon se vlerësimi i gjendjes faktike lidhur me dashjen dhe bashkëkryerjen është bërë në shkelje të parimit *in dubio pro reo* (neni 3(2) i KPP-së) dhe të pavarësisë së gjykatës (neni 8(2) i KPP-së). Prandaj, mbrojtja pretendon se dashja e të pandehurit nuk ishte dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm sepse i pandehuri nuk ka mundur të parashikojë se veprimet e tij dosido do të afektojnë vrasjen e X.H.K. t. Në lidhje me këtë, të dy gjykatat nuk kanë dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se I.B. G. i i ka dhënë (G.G. shit ndonjë shenjë ose se kishte armë në duart e të

pandehurit. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh se **B.G.** i ishte ballafaquar me **X.H.N.** në shtëpi për një periudhë prej 8-10 sekonda duke u munduar ta nxirrte jashtë veturës, dhe nuk ka vlerësuar mundësinë e besueshmërisë së deklaratave të dy kalimtarëve.

13. Avokati mbrojtës më tutje pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk ka dëshmuar elementin e bashkëkryerje siç përcaktohet në nenin 31 të KPK-së. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk arriti të vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm se (1) **G.G.** i e ka njohur **X.H.N.** apo makinën e tij, dhe se nuk kishte njohuri lidhur me ndonjë konflikt mes **X.H.K.** i qit dhe **B.G.** t; (2) **G.G.** dinte se **B.G.** i kishte një armë; (3) **G.G.** mund të parashikonte se **B.G.** i do të përdorte armën për ta qëlluar në **X.H.N.** in; (4) veprimet e viktimës dhe të **B.G.** do të çonin deri te vrasja.

14. Avokati mbrojtës më tutje parashtron se gjykatat kanë gabuar në kualifikimin e veprës penale si vrasje e rëndë. Nuk është e mjaftueshme për të provuar se ka pasur rrezik abstrakt për të rrezikuar jetën e një ose më shumë personave, duhet të ekzistojë një rrezik konkret dhe kryerësi duhet me qëllim të rrezikojë jetën e një personi tjetër, gjatë kryerjes së vrasjes. Përveç kësaj, identifikimi specifik i personit të rrezikuar apo personave është një element i domosdoshëm i kësaj vepre penale. Për të mbështetur argumentin e tij, mbrojtësi i bashka ngjet aktgjykimet e mëparshme të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Në rastin konkret, nuk ka pasur rrezikim konkret të asnjë personi, përkundrazi, E **B.G.** i gjatë gjithë kohës ka pasur nën kontroll të plotë armën e tij dhe të shtënat ishin drejtuar vetëm në **X.H.N.** in dhe automjetin e tij. **G.G.** nuk mund të konsiderohet përgjegjës për të shtënat në qebaptore nga **X.H.N.**

15. Avokati mbrojtës pretendon se veprimet e **G.G.** duhet të cilësohen si pjesëmarrje në rrahje nga neni 190(1) i KPK-së. Ai paraqet një shembull të praktikës gjyqësore që shpjegon dallimin e bashkëpunimit dhe ndihmës që është një element i veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje, dhe bashkëkryerjen si element i vrasjes së rëndë. I pandehuri nuk ka pasur asnjë kontakt fizik me viktimën dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohet si bashkëkryerës.

16. Si alternativë, Avokati mbrojtës pretendon se gjykatat është dashur që veprimet e G. G. t'i cilësojnë si vrasje nga neni 178(1) i KPK-ës në lidhje me nenin 31 të KPK-së, dhe ndaj tij të shqiptohet një dënim më i lehtë.

Parashtrësit e Prokurorit të EULEX-it në Mitrovicë

17. Prokuroria e EULEX-it konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. 132/14 i datës 30 korrik 2015 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR 474/15 i datës 14 janar 2016 janë të vlefshëm dhe në pajtim me kërkesat e KPK-së dhe KPP-së.

18. Shumica e argumenteve të paraqitura nga mbrojtësi janë të lidhura me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e cila nuk mund të jetë bazë për kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në pajtim me nenin 432 (2) të KPP-së. Në çdo rast, dëshmitë duke përfshirë edhe video incizim u vlerësuan dhe u interpretuan si duhet nga të dyja gjykatat.

19. Lidhur me kualifikimin e veprës penale, Prokuroria e EULEX-it tregon se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë vlerësuar saktë rrezikimin e jetës së një ose më shumë personave. Në këtë drejtim, gjykatat kanë identifikuar rrethanat konkrete në të cilat personat konkret janë rrezikuar, dy prej të cilëve madje kanë dëshmuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

20. Prokuroria e EULEX-it më tej argumenton se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se G. G. ishte në dijeni të sulmit, dhe mori veprime aktive për të kontribuar në sulm. Prandaj, nuk ka dyshim se G. G. i ka vepruar në bashkëkryerje dhe se kishte dashje eventuale. Veprimet e tij nuk përbëjnë veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje në bazë të nenit 190 (1) të KPK-së.

Parashtrësit e Prokurorisë së Shtetit

21. Prokuroria në përgjigjen e vet i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar në pajtim me nenin 437 të KPP-së. Prokuroria

pretendon se shumica e argumenteve të paraqitura nga avokati mbrojtës kanë të bëjnë me vlerësimin e gjendjes faktike. Këto argumente duhet të hidhet poshtë si të papranueshme në përputhje me nenin 432 (2) të KPP-së.

22. Sa i përket shkeljeve esenciale të pretenduara të ligjit të procedurës, Prokuroria pretendon se mbrojtja nuk ka dhënë asnjë argument të vlefshëm për të mbështetur pretendimin se dispozitivi është i pakuptueshëm, se Gjykata e Apelit nuk ka shqyrtuar të gjitha pjesët e aktgjyqimit të shkallës së parë të kontestuar nga mbrojtja, ose se vendimi i Gjykatës së Apelit është në kundërshtim me vetveten. Mbrojtja më tej nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për shkelje të nenit 432 (1) (1) të KPP-së në lidhje me shkeljen e ligjit penal. Të gjitha argumentet janë të lidhura me vlerësimin e gjendjes faktike dhe për këtë arsye kërkesa duhet të hedhet poshtë.

### III. Përbërja e kolegjit

23. Kolegji konstatoi se më 2 korrik 2014, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka konfirmuar se EULEX-i ka juridiksion në çështjen PP 10/14. Kolegji ka vendosur njëzëri se në bazë të nenit 1A (1.4) të ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e misionit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë (05 / L-103) (tani e tutje "Ligji Omnibus") *inter alia* me të cilin është ndryshuar ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (03 / L-053), ky rast konsiderohet si "rast në proces". Prandaj, gjyqtarët e EULEX-it kanë juridiksion në këtë rast. Në përputhje me nenin 3.3 të Ligjit Omnibus, trupi gjykues do të përbëhet nga shumica e gjyqtarëve vendorë dhe do të kryesohet nga një gjyqtar vendor.

### IV. Gjetjet

#### Pranueshmëria e kërkesave

24. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës **M. H.** i në emër të të pandehurit **G. G.** është e pranueshme. Kërkesa është paraqitur nga personi i autorizuar (neni 433 (1) i KPP-së), në afatin e përcaktuar ligjor (neni 433 (2) i KPP-së), dhe në gjykatën kompetente (neni 434 (1) i KPP-së).

#### Meritat e kërkesës



- *Pretendimet mbi vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*

25. Fillimisht, kolegji vëren se një pjesë e madhe e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundërshton vlerësimin e provave të bërë nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. Në veçanti, mbrojtja kundërshton vlerësimin e video incizimit nga kamera CCTV në lokalin “X...”. Në lidhje me këtë, sipas nenit 432 (1) të KPP-së, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm në rast të shkeljes së ligjit penal, në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, ose në rast të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Neni 432 (2) i KPP-së në mënyrë strikte dhe të qartë përcakton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet për shkak të përcaktimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike. Vetëm një mosmarrëveshje lidhur me vlerësimin faktit të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk i përmbush kushtet për kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë siç është përcaktuar me nenin 432(1) të KPP-së. Prandaj, kolegji gjen se të gjitha pretendimet lidhur me vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike do të hedhen poshtë si të papranueshme.

- *Dispozitivi i pakuptueshëm dhe kundërthënës*

26. Mbrojtja pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me përmbajtjen e shkresave të lëndës. Kolegji konsideron se dispozitivi i aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit është hartuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 370 (3) dhe (4) në lidhje me nenin 365 të KPP-së. Dispozitivi përmban përshkrim të plotë të veprës për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor së bashku me përshkrimin e fakteve dhe rrethanave që tregojnë natyrën kriminale të akteve dhe zbatimin e dispozitave përkatëse të ligjit penal.

27. Ndërsa është e saktë se dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore nuk liston emrat e njerëzve jetët e të cilëve janë rrezikuar gjatë të shtënave, kolegji nuk është i bindur se Gjykata Themelore ka dështuar që të konstatojë emrat e njerëzve jetët e të cilëve ishin të rrezikuar. Së pari, dispozitivi në mënyrë të qartë i referohet disa personave në rrugë, si dhe



dy personave brenda qebaptores. Më tej, emrat specifik të personave të prekur, dhe rrethanat që lidhen me rrezikimin e jetës së tyre janë adresuar në hollësi në arsyetimin kryesor të aktgjykimit. Aktgjykimi duhet të lexohet si një tërësi, përfshirë dispozitivin dhe arsyetimit. Prandaj, kolegji konsideron se mos përmendja e emrave të veçantë në dispozitiv nuk paragjykon të drejtat e të pandehurit dhe nuk ndikon në drejtësinë e gjykimit në tërësi.

28. Më tutje, kolegji konsideron se mospajtimi i mbrojtjes me gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv nuk i përbën shkelje të nenit 370(3) dhe (4) në lidhje me nenin 365 të KPP-së.

- *Shkelja e nenit 394(1) të KPP-së*

29. Më tej, mbrojtja pretendon se Gjykata e Apelit ka shkelur nenin 394 (1) të KPP-së, pasi që ose nuk ka dhënë ndonjë shpjegim se pse u refuzua ankesa, ose ka dhënë sqarime të cilat janë në kundërshtim me provat e lëndës. Mbrojtja argumenton se Gjykata e Apelit nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me kundërtënit në përmbajtjen e lëndës dhe arsyetimin. Përkitazi me këtë, kolegji konsideron se Gjykata e Apelit në mënyrë të qartë dhe gjerësisht ka adresuar pretendimet e vërtetimit të gabuar dhe/ose jo të plotë të gjendjes faktike të ngritura nga mbrojtja në ankesën e tij (*shih* faqet 8-9 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit). Prandaj, kolegji konstaton se Gjykata e Apelit ka adresuar pjesët e aktgjykimit të Gjykatës Themelore të kundërshtuara nga ana e mbrojtjes, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 394 (1) të KPP-së. Pyetja nëse gjendja faktike është vlerësuar si duhet, është jashtë fushëveprimit të këtij aktgjykimi. Prandaj, pretendimi se neni 394 (1) i KPP-së është shkelur, refuzohet si i pabazuar.

- *Shkelja e parimit in dubio pro reo dhe pavarësia e gjykatave*

30. Mbrojtja pretendon se aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë kanë shkelur parimin *in dubio pro reo* (neni 3(2) i KPP-së) dhe pavarësinë e gjykatës (neni 8(2) i KPP-së) sepse vlerësimi i gjendjes faktike është bërë në dëm të të pandehurit.

31. Kolegji vëren se parimi *in dubio pro reo* është një rezultat i rëndësishëm i prezumimit të pafajësisë, dhe kusht i të provuarit përtej çdo dyshimit të arsyeshëm. Kjo do të thotë se çdo

paqartësi ose dyshim që lind nga provat e gjykimit duhet të zgjidhet në favor të të akuzuarit. Ky parim parashikon që, kur është e mundur që një gjykatë të nxjerrë një apo më shumë konkluzione nga faktet të cilat janë të vërtetuara qoftë nga provat e drejtpërdrejta ose të tërthorta, duhet të konsiderojnë nëse ndonjë konkluzion i tillë i hapur ndaj fakteve është në mospërputhje me fajësinë e të akuzuarit . Me fjalë të tjera, ky parim kërkon që të trajtohen të gjitha paqartësitë lidhur me fajësinë në dobi të të pandehurit.

32. Është e rëndësishme të theksohet, se parimi është i zbatueshëm kur vlerësohet tërësia e provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor, dhe jo të provave individuale. Është vërtetuar edhe nga Gjykata e Supreme dhe nga jurisprudenca e gjykatave ndërkombëtare se parimi *in dubio pro reo* nuk është i zbatueshëm për prova dhe gjetje individuale të cilat ky aktgjykim nuk i zbaton.<sup>1</sup>

33. Në rastin konkret, mbrojtja ka paraqitur një interpretim të ndryshëm të provave të lëndës i cili tashmë është adresuar nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. Të dy gjykatat kanë konstatuar se i vetmi përfundim që rrjedh nga pamjet video është ai i cili vërteton fajësinë e të pandehurit. Interpretimi i ndryshëm i gjendjes faktike, dhe pretendimi që të njëjtat fakte duhet të cilësohen si vepër tjetër penale nuk do të thotë se është shkelur parimi *in dubio pro reo*.

34. Në përputhje me nenin 8 të KPP-së, parimi i pavarësisë së gjyqësorit do të thotë se gjykata merr vendimet në bazë të ligjit, dhe në bazë të provave të shqyrtuara dhe vërtetuara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në lidhje me këtë, kolegji konsideron se provat janë mbledhur dhe shqyrtuar në mënyrë të duhur gjatë shqyrtimit gjyqësor, palët kanë pasur mundësinë për të kundërshtuar secilën provë; mbrojtja nuk ka kundërshtuar provat e paraqitura dhe të vërtetuara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Prandaj, kolegji nuk sheh asnjë shkelje të parimit të pavarësisë së gjyqësorit.

- *Cilësimi i veprës si Vrasje e rëndë sipas nenit 179(1)(5) të KPK-së*

---

<sup>1</sup> *Shih*, Gjykata Supreme, lënda Pml.Kzz 8/2015, paragrafët 4.23 dhe 4.24; GjPN, *Prokurori kundër Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu*, IT-03-66-A, aktgjykimi, 27 shtator 2007, faqe 11.

35. Mbrojtja më tutje pretendon se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë gabuar në përcaktimin se janë rrezikuar jetët e njerëzve të tjerë. Mbrojtja pretendon se rreziku duhet të jetë konkret dhe i drejtuar kundër personit konkret. Veprimet e I B.G. hit kanë qenë të koordinuara dhe ai ka shtënë vetëm në drejtim të X.H. N. it dhe automjetit të tij. Ndërsa të shtënat në drejtim të qebaptores dhe njerëzve të cilët ishin duke ecur në rrugë kanë ardhur nga arma e X.H. N. Prandaj, mbrojtja pretendon se i pandehuri nuk mund të mbahen përgjegjës për veprimet e X.H. N. t.

36. Rrezikimi i jetës së personave të tjerë siç është përcaktuar në nenin 179(1)(5) të KPK-së do të thotë se kryerësi prodhon me paramendim dy pasoja me një veprim të vetëm: duke marrë jetën e një personi dhe rrezikimin e jetës së një personi tjetër. Rreziku për personin tjetër duhet vërtetë të ndodhë; rreziku kështu duhet të jetë konkret dhe jo abstrakt. Paramendimi mund të jetë i drejtpërdrejtë apo i rastësishëm, në lidhje me vrasjen, si dhe në lidhje me shkaktimin e rrezikut konkret për jetën e një ose më shumë personave. Kjo do të thotë se personi ka qenë në dijeni se veprimi i ndërmarrë, mënyra e zbatuar dhe mjetet e përdorura, si dhe rrethanat e tjera ekzistuese mund të vënë në rrezik konkret jetën e një personi tjetër apo personave, dhe ai megjithatë pajtohet me atë pasojë.

37. Në rastin konkret, kolegji vëren se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë vërtetuar qartë se G.G. bashkë me B.N. kanë sulmuar X.H. K. dhe këto veprime përfundimisht kanë rezultuar në një seri të shtënash. Në këtë rast, veprimet e G.G. dhe B.G. kishte një pasojë të parashikuar të të shtënave në vend publik, ku kishte disa njerëz të pranishëm. Është e parëndësishme se kush ka shtënë. Po ashtu, për qëllime të dashjes saktësia e rezultatit të mundshëm nuk është e domosdoshme. Ajo që ka rëndësi në këtë rast, është se kryerësi e ka ditur ose duke marrë parasysh karakteristikat e sulmit ndaj X.H.K. mund ta ketë ditur se pasoja e ndaluar mund të ndodhë, dhe megjithatë ka vazhduar me veprimet e tij. Prandaj, kolegji konstaton se G. i kontribuar ndjeshëm në veprimet që çojnë në rrezikimin e jetës së një ose më shumë personave.

38. Më tutje, kolegji vëren se Gjykata e Apelit ka analizuar me kujdes jurisprudencën e paraqitur nga mbrojtja duke përcaktuar nëse rreziku ka qenë specifik dhe real dhe nëse personat

konkret janë rrezikuar. Kolegji plotësisht pajtohet me përfundimin e Gjykatës së Apelit se doktrina e precedentit thekson se rastet duhet të vendosen në të njëjtën mënyrë vetëm kur faktet e tyre materiale janë të njëjta. Në lëndën në fjalë është përcaktuar në mënyrë të qartë se rreziku ka qenë i vërtetë dhe specifik, dhe ishte drejtuar kundër personave të identifikuar në mënyrë të qartë. Prandaj, kolegji plotësisht pajtohet me konstatimet e bëra nga Gjykata e Apelit, dhe konsideron se elementi i rrezikimit të jetës së një ose më shumë personave është vërtetuar plotësisht. Vepra penale është cilësuar në mënyrë korrekte si vrasje e rëndë sipas nenit 179 (1) (5) të KPK-së, dhe nuk mund të cilësohet si vrasje sipas nenit 178 të KPK-së.

- *Bashkëkryerja dhe dashja eventuale*

39. Mbrojtja më tutje pretendon se veprimet e të pandehurit nuk tregojnë se ai ka mundur ta parashikojnë rezultatin e vrasjes. Prandaj, mbrojtja pohon se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë gabuar në përcaktimin se i pandehuri ka pasur një qëllim eventual dhe vullnetshëm ka pranuar veprimet e *B.G.* si të vetat si bashkëkryerës. Prandaj, veprimet e *G.G.* mund të cilësohen vetëm si pjesëmarrje në rrahje siç është përcaktuar në nenin 190 (1) të KPK-së.

40. Neni 31 i KPK-së përcakton bashkëkryerjen si “nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale”. Elementet e bashkëkryerjes, sipas këtij neni janë: shumësi i personit, pjesëmarrja në kryerjen ose duke dhënë një kontribut vendimtar i cili është i rëndësishëm dhe pa të cilin nuk do të kryhet vepra penale, ose nuk do të kryhej në mënyrën e planifikuar, dhe gatishmëria për të kryer vepër penale, si të vetën (dashjen e përbashkët). Bashkëkryerja është një formë e kryerjes, ku disa persona, secili prej tyre përmbush elementet e kërkuara të kryerësit, me vetëdije dhe vullnetshëm kryejnë vepra të caktuara penale. Për dallim nga ndihmësi ose nxitësi, bashkëkryerësit nuk marrin pjesë në një akt të kryer nga një person tjetër. Bashkëkryerësi merr pjesë në veprimet e tij, ndërsa ndihmësit dhe nxitësit marrin pjesë në veprimet e dikujt tjetër.

41. Mbrojtja pretendon se nuk është vërtetuar asnjë plan i përbashkët dhe se i pandehuri nuk ka mundur ta parashikojë se veprimet e tij ose të E. B. G. do të rezultojnë në vrasjen e X.H. R. Në këtë drejtim, mbrojtja kundërshton "kontrollin mbi krimin" elementin e bashkëkryerjes. Kolegji vëren se ky element do të thotë se bashkëkryerësit ndajë detyrat themelore mes tyre, veprojnë në mënyrë të organizuar dhe në këtë mënyrë ndajnë kontrollin mbi krimin. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se bashkëkryerësit duhet të bien dakord për të kryer një krim të caktuar; është e mjaftueshme të tregohet se veprimet e tyre ishin të koordinuara. Gjithashtu, marrëveshja nuk ka nevojë të jenë eksplicite dhe mund të nxirret nga veprimi pasues i përbashkët i bashkëkryerësve.<sup>2</sup> Veprimet e secilit bashkëkryerës çojnë në një kontribut thelbësor të koordinuar nga secili bashkëkryerës që rezulton në realizimin e elementeve objektive të krimit.

42. Në rastin konkret, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë konstatuar se veprimet e të pandehurit duke e bllokuar Mercedes-in dhe duke nxituar drejt derës së pasagjerit të Mercedes-it në mënyrë që të pengojnë X.H.N. në veprimin mbrojtës ishin kryesore në kryerjen e veprës penale. Në kundërshtim të pretendimit të mbrojtjes, veprimet e të pandehurit ishin të koordinuara dhe në mënyrë të qartë kanë treguar se i pandehuri ishte në dijeni të situatës në përgjithësi. Kolegji është i mendimit se nëse G.G. i e ka njohur viktimën ose makinën e tij, apo nëse ai e dinte se B.G. i kishte armë, është e parëndësishme për cilësimin e veprës penale. Për më tepër, është gjithashtu e parëndësishme për cilësimin e veprës penale nëse B.G. hi është konfrontuar me X.H.N. për të paktën 8-10 sekonda duke u përpjekur që ta tërheqë atë nga makina.

43. Më tutje, mbrojtja pretendon se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë gabimisht kanë përcaktuar se i pandehuri kishte qëllimin eventual dhe se ka pranuar pasojat e vrasjes së X.H.N. Kolegji vëren se dashja kriminale nuk do të thotë qëllim keqdashës, dhe një person mund të ketë dashje kriminale edhe kur motivet e tij janë objektivisht të mira. Sidoqoftë, në rastet kur një person ka për qëllim që të kryejë vepër penale, por nuk formon dashjen para se të ndërmarrë veprime (e cila do të përbënte keqdashje të paramenduar),

<sup>2</sup> Prokurori kundër Thomas Lubanga Dyilo, vendimi mbi konfirmimin e akuzave, 29 janar 2007, ICC-01/04-10/06-803, paragrafët 344-345. Shih gjithashtu, Prokurori kundër Germain Katanga dhe Mathieu Ngudjolo Chui, vendimi mbi konfirmimin e akuzave, 26 shtator 2008, paragrafi 484; Prokurori kundër Jean Pierre Bemba, vendimi mbi konfirmimin e akuzave, 15 qershor 2009, paragrafi 348.

konsiderohet se personi megjithatë ka vepruar me dashje. Në lëndën në fjalë, është e qartë se ( G.G. vullnetshëm dhe në mënyrë aktive ka kontribuar në sulmin kundër XH. N. edhe pse ai mund të mos ketë pasur për qëllim që ta vrasë atë. Prandaj, kolegji konsideron se gjykatat kanë përcaktuar drejtë se ( G.G. i nuk ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë për ta vrasë XH. K. , i pasi që nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se plani për ta vrasë XH. N. është formuar para sulmit. Akti i bllokimit të makinës dhe marrja e rolit aktiv në përpjekje për të ndaluar XH. N. nga vetëmbrojtja në mënyrë të qartë tregon qëllimin eventual të të pandehurit. Ai ishte në dijeni se kishte rrezik të konsiderueshëm që elementet objektive të krimit do të kryheshin dhe megjithatë ka marrë pjesë aktive në veprimet që kanë kontribuar ndjeshëm në vrasjen e XH. N.

44. Për këtë arsye, kolegji konsideron se mbrojtja nuk arriti të vërtetojë elementet e veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje, siç parashikohet në nenin 190 (1) të KPK-së. Nuk ka asnjë indikacion që vërteton se veprimet e të pandehurit mund të cilësohen si bashkëpunim apo ndihmë për kryesin e rrahjes. Për më tepër, praktika gjyqësore e paraqitur nga mbrojtja nuk është e zbatueshme në rastin në fjalë, siç është përcaktuar nga Gjykata e Apelit.

45. Prandaj, kolegji gjen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë përcaktuar drejt elementet e krimit dhe konsideron se mbrojtja nuk arriti të provojë shkeljen e ligjit penal. Parashtrësja e mbrojtjes për ri-cilësimin e veprës penale si pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 (1) të KPK-së, refuzohet si e pabazuar.

## V. PËRFUNDIM

Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
PRISHTINË**

**PML-138/16**

**Kryetare e kolegjit:**

---

**Valdete Daka**  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës

**Anëtarët e kolegjit:**

---


**Elka Filcheva-Ermenkova**  
Gjyqtare e EULEX-it në Gjykatën Supreme të Kosovës

---

**Nebojsa Boricic**  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës

---

**Mentor Osmani**  
Përkthyes i EULEX-it

Republika e Kosovës  Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJES E VËRTETON  
ТАЧНОСТ ОТПРАВКИ Копии  
**Sandra Cudaj**  
Zyrtare ligjore e EULEX-it  
Punëtori i autorizuar  
Ovlaštení radnik

